

A K T I I T H E M E L I M I T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "EUROLAB-INTERNACIONAL"

I lidhur sot me date ___ . ___ .1995 ne Vlore,ndermjet personave te pranishem si me poshte:

- 1 - GRASSI Luigi, shtetas italian, lindur me 12.12.1954 ne Torremaggiore te Italise dhe banues po aty.
- 2 - Dritan BELLAJ, shtetas shqiptar, lindur me 12.05.1970 ne Vlore dhe banues po aty.
- 3 - Patriot ISLAMI, shtetas shqiptar, lindur me 12.01.1957 ne Sevaster te Vlores dhe banues ne Vlore, lagja "Muradie", rruga "Ceno Sharra", Nr.37.

Personat fizike te mesiperem, ketu me poshte ne kete AKT THEMELIMI te quajtur bashkarisht ose vecmas "ORTAKE", kane rrene dakort si me poshte:

Neni 1 - EMERTIMI, QENDRA DHE AFATI I SHOQERISE

ORTAKET, ne marrveshje unanime midis tyre, themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te se drejtes shqiptare.

Emertimi i plote i SHOQERISE do te jete "EUROLAB-INTERNACIONAL" Sh.p.k.

Qendra (selia) e SHOQERISE eshte ne qytetin e Vlores, ne adresen "Lagja "Muradie", rruga "Ceno Sharra", Nr.37.

SHOQERIA, me vendim te organeve te saj, mund te themeloje ose anulojte seli sekondare, filiale, perfaqesi, dege e agjensi, brenda ose jashte shtetit.

Kohezgjatja e SHOQERISE fillon ditën e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregetar dhe mbaron ne ditën e 31 Dhjetorit te vitit 2025 (dymije e njezete e pese).

Asambleja e Ortakeve, ne perputhje me parashikimet ne dispozitat e STATUTIT te SHOQERISE mund te zgjate ose te vendose mbarimin parakohe te SHOQERISE.

Neni 2 - NATYRA JURIDIKE DHE TREGETARE E SHOQERISE

SHOQERIA eshte person juridike privat i se drejtes shqiptare, veprimtaria e te ciles rregullohet nga ky akt themelues, statuti i saj si dhe legjislacioni shqiptar ne pergjithsi.

SHOQERIA pergjigjet kundrejt te treteve vetem me pasurite e saj dhe ne asnjë rast nuk pergjigjet per detyrimet e mara persiper nga vete ORTAKET.

ORTAKET pergjigjet per detyrimet e SHOQERISE dhe perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te SHOQERISE.

SHOQERIA nuk pergjigjet per detyrimet e shtetit shqiptar dhe anasjelltas.

Luigi Grassi
Dritan Bellaj

P. Islami

dhe mjeteve per qellime turistike.

SHOQERIA ka te drejten te marre pjese ne fitime te shoqerive te tjera te se drejtes shqiptare apo te shteteve te tjera si dhe te krijoje shoqeri te tjera, me persona fizike dhe juridike, publike dhe private, vendas apo te huaj.

SHOQERIA mund te ushtroje veprimtari industriale per nxjerjen dhe perpunimin e lendeve te para.

Te gjitha veprimtarite e mesiperme mund te ushtrohen ne Shqiperi dhe jashte saj, me punonjes vendas apo te huaj.

SHOQERIA ka te drejte qe per te tilla veprimtari te marre financime qe i sherbejne zhvillimit shoqeror, duke u vene keto financime ne dispozicion qofte nga qeveria shqiptare ose nga Komuniteti European, per vendet ne zhvillim.

Neni 4 - KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i SHOQERISE ne çastin e themelimit te saj eshte 100.000 (njqintemije) leke, eshte teresisht kapital financiar i depozituar ne Banken Kombetare Tregtare, ne emer te SHOQERISE.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjese (kuota) me vlefte 1.000 (njem) leke sejcila kuote.

Pjesmarja e sejcilit ortak ne kapitalin themeltar te SHOQERISE eshte:

- GRASSI Luigi 51 kuota ose 51% te kapitalit themeltar
- Dritan BELLAJ 27 kuota ose 27% te kapitalit themeltar
- Patriot ISLAMI 22 kuota ose 22% te kapitalit themeltar

Kapitali themeltari SHOQERISE mund te zmadhohet, pakesohet, cedohet, transferohet apo tjetersohet ne perputhje me parashikimet e bera ne dispozitat perkatese te STATUTIT te SHOQERISE si dhe ato te parashikuara ne ligjin Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Cdo veprim lidhur me kapitalin themeltar te SHOQERISE do te behet ne monedhe shqiptare.

Fondet ne te holla, te ardhura nga shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar do te rregjistrohen ne librin e llogarive te SHOQERISE, ku detajohet kontributi i derdhur nga sejcili ORTAK.

Neni 5 - PERSONALITETI JURIDIK

SHOQERIA do te kete zotesi te fitoje te drejta dhe te marre persiper detyrime qe nga çasti i rregjistrimit te saj sipas formaliteteve te

DRITAN BELLAJ

[Signature]

[Signature]

[Handwritten signature]

parashikuara me ligj ne rregjistrin tregetar te Gjykatës se rrethit Tirane. SHOQERIA do te filloje ushtrimin e veprimtarive sipas objektit te saj pas perfundimit te formaliteteve sipas ligjes me organin kompetent tatimor dhe organet kompetente per dhenien e autorizimeve te duhura per ushtrimin e atyre veprimtarive.

Neni 6 - VITI FINANCIAR

Viti financiar(ushtrimor) i SHOQERISE fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti kalëndarik. Viti i pare financiar do te mbyllet me 31 Dhjetor 1996(nentedhjete e gjashte).

Neni 7 - FITIMI I SHOQERISE

Destinacioni i fitimit neto te SHOQERISE, mbas zbritjes se detyrimeve fiskale dhe te tjera ne perputhje me ligjin, percaktohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 8 - DETYRIMET E ORTAKEVE THEMELUES

ORTAKET themelues, delegojne Administratorin e Vetem qe te ndjeke, kujdeset dhe permbushe te gjitha veprimet dhe aktet e nevojshme per themelimin e SHOQERISE dhe, gjithashtu, te permbushe te gjitha formalitetet e duhura te pasqyrimin ne kete AKT THEMELIMI dhe ne STATUTIN bashkengjitur, te te gjitha ndryshimeve te duhura ose te kerkuara nga organet kompetente me qellim te njohjes se SHOQERISE.

Neni 9 - ORGANET E SHOQERISE

Organet e SHOQERISE jane:

- 1 - Asambleja e Ortakeve
- 2 - Administratori i Vetem

SHOQERIA ne te ardhemen mund te shtoje organet e saj te cilet mund te jene Keshilli Administrativ apo Administratori i Deleguar.

Administrator i Vetem i SHOQERISE do te jete ORTAKU Patriot ISLAMI.

Kompetencat, detyrat, perberja dhe funksionet e kohezgjatja e organeve te SHOQERISE percaktohen ne STATUTIN e saj.

Neni 10 - FSHEHTESIA E INFORMACIONIT

ORTAKET marrin persiper te ruajne karakterin konfidencial te dokumentacionit, te informacionit, te te dhenave dhe pervojës se fituar gjate veprimtarise se SHOQERISE si dhe te marrin masat e nevojshme per te penguar perhapjen e tyre ne çfaredo menyre qofte.

ORTAKET pergjigjen per pasojat e demshme te shkaktuara SHOQERISE nga mosrespektimi i detyrimeve te lartepermendura.

DRITAN BELLAJ
(Bellaj)

P. Jale
(Jale)

Qisq' Rama
(Rama)

Neni 11 - MOSMARRVESHJET

Zgjidhja e mosmarrveshjeve qe mund te lindin ndermjet ORTAKEVE,ose midis ORTAKEVE dhe SHOQERISE,lidhur me interpretimin ose zbatimin e AKTI THEME-
LIMI dhe STATUTIT te SHOQERISE,ato do te zgjidhen sipas parashikimeve te
bera ne STATUTIN bashkelidhur ketij AKTI THEMELIMI.

Neni 12 - STATUSI I AKTIT TE THEMELIT DHE I STATUTIT TE SHOQERISE
SHOQERIA deklârohet e themeluar dhe veprimtaria e saj e rregulluar ne
perputhje me dispozitat e ketij AKTI THEMELIMI dhe STATUTIT te SHOQERISE
dhe qe jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 13 - SHPENZIMET E THEMELIT TE SHOQERISE

Shpenzimet per hartimin dhe nenskrimin e ketij AKTI THEMELIMI ashtu si
dhe gjithë shpenzimet per njohjen ligjore dhe rregjistrimin e SHOQERISE
jane ne ngarkim te kesaj te fundit.

Neni 14 - DISPOZITE E FUNDIT

Ky akt themelimi i hartua ne 5(pese)faqe te daktilografuara ne gjuhen
shqipe si dhe ne tre te tjera te perkthjera ne Italisht te vertetuara
tek noteri,njeren kopje te te cilave e mban shoqeria,ndersa kopjet e
tjera do te depozitohen ne organet kompetente.

ORTAKET,pasi e lexuan,e kuptuan dhe e pranuan kete AKT THEMELIMI e nen-
shkruan ate ne te pese kopjet e tij,sot me date __.__.1995 dhe nga ky
çast ,ky eshte i detyrueshem per te gjithë ORTAKET.

O R T A K E T E S H O Q E R I S E

GRASSI LUIGI

DRITAN BELLAJ

PATRIOT ISLAMI

Ky AKT THEMELIMI u perpilua nga Av.Pelivan Malaj

AVOKAT
Dott. PELIVAN MALAJ
Rruga "M. Xhaferi"
VLORE - Tel. 2043

NOTERE
DRITA AGA
TEL 257 15
VLORE

Republika e Shqiperise

Ministria e Drejtesise

Dhoma e Notereve Vlore Notere Drita

3893

V e r t e t i m

Ne Vlore sot me daten 5 Gusht u paraqiten ne noteri Ortaket pjes
marres ne Shoqerine si me siper te themeluar , madhor

S T A T U T I

I SHOQERISE SHQIPTARO-ITALIANE "EUROLAB-INTERNACIONAL" Sh.p.k.

Shoqeria tregtare me pergjegjesi te kufizuar "EUROLAB-INTERNACIONAL" eshte themeluar ne baze te Aktit Themelues te nenshkruar nga ortakët GRASSI LUIGI, DRITAN BELLAJ dhe PATRIOT ISLAMI.

ORTAKET jane marre vesh qe pervec sa eshte parashikuar ne AKTIN THEMELUES, rregullat e mardhenieve dhe te veprimtarise se SHOQERISE do te parashi-kohen nga ky STATUT.

T I T U L L I 1

Emertimi-Vula, Qendra-Kohezgjatja-Objekti

Neni 1 -EMERTIMI I SHOQERISE

SHOQERIA do te kete emrtimin "EUROLAB-INTERNACIONAL" Sh.p.k.

Neni 2 -VULA DHE PUBLIKIMET E SHOQERISE

SHOQERIA ka vulen e saj, permbajtja e se ciles do te jete si vijon:
"EUROLAB-INTERNACIONAL SH.P.K."

Te gjitha aktet dhe dokumentet qe do te nxjerre SHOQERIA drejtuar te treteve ose publikut, duhet te tregojne qarte e lexueshem emertimin e SHOQERISE dhe pas tij fjalet "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" ose "sh.p.k." si dhe emrin e administratorit te SHOQERISE.

Neni 3 -QENDRA E SHOQERISE - VENDBANIMI I ORTAKEVE

Qendra e SHOQERISE ndodhet ne qytetin e Vlores, Lagja "Muradie", Rruga "Ceno Sharra", Nr.37.

SHOQERIA, me vendim te Asamblese se Ortakeve, te Keshillit Administrativ ose te Administratorit te Vetem, mund te themeloje, transferoje ose anuloje seli dytesore, seli administrative, filiale, agjensi, dege, perfaqesi dhe zyra edhe ne lokalitete te tjera si ne Shqiperi ashtu dhe jashte saj.

Vendbanimi apo vendndodhja e sejcilit ortak nenkuptohet te jete zgjedhur ajo e qendres se SHOQERISE ose vendbanimi i rregjistruar se fundi ne rregjistrin e SHOQERISE.

Neni 4 -KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e SHOQERISE fillon ditën e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregetar dhe mbaron ditën e 31(tridhjetë e një) Dhjetorit te vitit 2025 (Dymije e njezete e pese).

LUIGI GRASSI

DRITAN BELLAJ

Patriot Islam

2/13/25

Neni 5 - OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se SHOQERISE eshte:

Operacione dhe transakcione te çdo lloji lidhur me importimin,eksportimin, tranzitimin dhe tregjetimin e mallrave te ndryshem, industriale dhe ushqimore, te gateshem ,gjysem te gateshem apo si lende e pare, paisje e makineri e pjese kembimi, karburante e lubrifikante, me pakice dhe me shumice.

Veprimtari ne fushen e peshkimit dhe te akuakultures, duke perfshire te gjitha aktivitetet qe pambledh kjo fushe qe nga rritja, zenia, perpunimi dhe tregjetimi i peshkut dhe prodhimeve te tjera te detit dhe ujrave ne pergjithsi, veprimtari ne drejtim te permirsimit te flores dhe faunes detare , tokesore e ujore ne pergjithsi.

Veprimtari ne fushen e specializimit dhe asistences teknike ne fushen e peshkimit dhe akuakultures.

SHOQERIA mund te ushtroje veprimtari blerje, shitje apo dhenie me qira te pasurive te pajulteshme si banesa, troje etj., nepermjet ngritjes se zyrave perkatese qe do te ushtrojne kete lloj aktiviteti.

SHOQERIA mund te ushtroje veprimtari ne fushen e transportit te mallrave dhe udhetareve, per llogari te SHOQERISE dhe te treteve, ne Shqiperi dhe jashte saj. Per te tilla aktivite SHOQERIA mund te bleje, jape me qira, jape me leasing, per te tregjetuar te gjitha mjetet dhe paisjet qe i sherbejne ketij qellimi, duke perfshire traktore (koka makinash), rimorkio, kamiona, mjete ngarkim shkarkimi, elevatore, konteniere, frigorifere, anije dhe avione te çfaredo lloj kapaciteti dhe per çdo gje tjeter te nevojshme. Gjithashtu SHOQERIA mund te ushtroje aktivitet per ruajtjen dhe parkimin e mjeteve te transportit si dhe per mirmbajtjen, rregullimin dhe ndertimin e te gjitha mjeteve te siperpermendura.

SHOQERIA mund te ushtroje dhe veprimtari te perfaqesimit te personave juridike dhe fizike, publike ose private, vendas ose te huaj.

SHOQERIA mund te ushtroje veprimtari te dhenies se konsulences teknike ne fushe te ndryshme qe kane lidhje me objektin e veprimtarise se SHOQERISE.

SHOQERIA mund te ndertoje, te jape me qira objekte si dhe te organizoje ne çfaredo forme veprimtari te llojit turistik, me perparesi zhvillimin e turizmit per te huajt ne Shqiperi. Per kete qellim SHOQERIA mund te ushtroje sherbime publike, bar-bufe, restorante, hoteleri, piano-bar, gastronomi, agjensi turistike, udhetimesh, ndermjetesi per dhenie me qira te objekteve turistike.

WIKI GRAB
[Signature]

BRITAN BEUA /
[Signature]

[Signature]

dhe mjeteve per qellime turistike.

SHOQERIA ka te drejten te marre pjese ne fitime te shoqerive te tjera te se drejtes shqiptare apo te shteteve te tjera si dhe te krijoje shoqeri te tjera me persona fizike e juridike, publike dhe private, vendas e te huaj

SHOQERIA mund te ushtroje veprimtari industriale per nxjerrjen dhe perpunimin e lendeve te para.

Te gjitha veprimtarite e mesiperme mund te ushtrohen ne Shqiperi dhe jashte saj, me punonjes shqiptarec apo te huaj.

SHOQERIA ka te drejte qe per te tilla veprimtari te marre financime qe i sherbijne zhvillimit shoqeror, duke u vene keto financime ne dispozicion qofte nga qeveria shqiptare ose nga Komuniteti Europian per vendet ne zhvillim.

Neni 6 - PERGJEGJESIA E SHOQERISE

SHOQERIA pergjigjet kundrejt te tretteve vetem me pasurite e saj dhe, ne asnje rast, ajo nuk pergjigjet per detyrimet e marra persiper nga ORTAKET dhe as keta te fundit nuk perballojne detyrimet dhe humbjet e SHOQERISE pertej kufirit te vlefes se kuotaes se pjesmarjes se tyre ne kapitalin themeltar te saj.

SHOQERIA nuk pergjigjet per detyrimet e shtetit shqiptar dhe anasjelltas.

Neni 7- E DREJTA PER INFORMACION

Secili ORTAK ka te drejte te kerkoje e te marre informacion prane organeve kompetente te SHOQERISE lidhur me ecurine e veprimtarise, administrimin dhe gjendjen e financave te saj.

Administratori eshte i detyruar te nise me poste ne vendbanimin e ortakeve brenda nje muaji nga fundi i çdo 4 mujori, duke filluar nga data 1 Janar, nje relacion financiar te SHOQERISE. Ky relacion duhet te permbaje te ardhurat, shpenzimet, fitimin dhe gjendjen e arkës.

Ky relacion eshte i vlefshem vetem per ortaket dhe administratoret.

Neni 8 - CILESIA E ORTAKUT

Cilesia e ORTAKUT vetkuptohet konsiderimi i qendres se SHOQERISE si adres dhe vendndodhje te ORTAKUT si dhe pranimi pa asnje kusht i dispozitave te aktit themelues, te statutit, te vendimeve te Asamblese se Ortakeve, edhe sikur dispozita te tilla te kene hyre ne fuqi para fitimit te kesaj cilesie

T I T U L L I ?

Kapitali themeltar-Transferimi i pjeseve te tij

Neni 9 - KAPITALI THEMELTAR

Vlera e kapitalit themeltar te SHOQERISE ne castin e themelimit te saj

SPRITAN BELLAJ

[Signature]

[Signature]

është në leke 100.000 (njqintemije), sipas çertifikates bankare që tregojnë derdhjen e kryer në Bankën Kombëtare Tregëtare, Dega e Vlores. Te gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar në teresinë e tyre nga ORTAKET dhe janë shlyer teresisht në të holla, sipas modaliteteve të përcaktuara në AKTIN E THEMELIMIT, ku secili ortak zoteron pjesët e tij të kapitalit themeltar, të ndara në kuota.

Vlefëta e çdo kuote të kapitalit themeltar është 1.000 leke. Kapitali themeltar i shoqërisë mund të rritet nëpërmjet nënshkrimit dhe derdhjes së kontributeve në të holla ose me anë të përfshirjes në të fituara ose që do të fitohen në mënyrë të palujtshme ose të lujtshme të vleresimit të tyre bëhet në përputhje me nenin 42 të Ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare". ORTAKET në marrëveshje midis tyre dhe në përputhje me aktet e SHOQËRISE, mund të vendosin rritjen ose pakësimin e vlefës së kapitalit themeltar. Çdo veprim lidhur me kapitalin themeltar të SHOQËRISE do të bëhet në monedhën shqiptare.

Fondet në të holla të ardhura nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar janë depozituar në llogarë bankare të hapur në emër dhe për llogarë të SHOQËRISE pranë Bankës Kombëtare Tregëtare, Dega e Vlores. Neclibrin e llogarive të SHOQËRISE rregjistrohet kapitali themeltar dhe detajohet kontributi i derdhur nga secili ORTAK. Në rast se SHOQËRIA do të financohet, të gjithë ORTAKET marrin pjesë në atë financim në proporcion me kuotën e pjesëmarrjes në kapitalin themeltar dhe financimi nuk do të prodhojë interesa.

Neni 10 - ZMADHIMI I KAPITALIT

Në të gjitha rastet e zmadhimit të kapitalit themeltar të vendosur nga Asambleja e Ortakëve, ORTAKET duhet të ushtrojnë të drejtën e nënshkrimit të kuotave të reja brenda 30 ditëve nga ajo e marrjes së atij vendimi ose nga ajo e njoftimit të atyre që mungonin në atë mbledhje, e cila dërgohet leter rekomande.

Në rast të mos nënshkrimit dhe mosderdhjes së kuotave të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar të tjere në proporcion me kuotën e tyre të pjesëmarrjes së kapitalin themeltar ekzistues.

Neni 11 - E DREJTA E PARABLERJES DHE CEDIMI OSE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Kuotat e pjesëmarrjes në SHOQËRI janë personale dhe të transferueshme. Trashëgimtarët e ORTAKUT të vdekur e zëvendësojnë pa kufizime në të drejtë trashëgimlënesin e tyre të vdekur.

Luigi Grassi
[Signature]

DRITAN BEÇIAJ
[Signature]

[Signature]

[Signature]

Ne rast te cedimit te kuotave nga ana e nje ORTAKU ,ceduesi ka si detyrim te njoftoje ORTAKET e tjere ne menyre qe ata te ushtrojne te drejten e parablerjes.Ne oferten e cedimit,e cila u behet e ditur te gjithë ORTAKEVE me leter rekomande,ORTAKU cedues duhet te tregojë vleren e cedimit dhe emrin e bleresit.

ORTAKET duhet te ushtrojne te drejten e parablerjes per te fituar ato kuota ose te njoftojne vullnetin e tyre se heqin dore nga blerja e tyre,brenda 30 diteve nga njoftimi si me siper.Ne rast te ushtrimit te se drejtes se parablerjes ORTAKET i blejne kuotat qe cedohen ne proporcion me pjesmarjen e tyre ne SHOQERI.

Ne rastin kur çmimi i kerkuar per cedimin e kuotave konsiderohet jo i drejt dhe i tepruar nga ORTAKET e tjere,keta te fundit duhet te kundërshtojne ate vlere shitje brenda tridhjete diteve nga njoftimi dhe çmimi do te përcaktohet nga nje ekspert ne baze te rezultateve te arritura ne bilancin e fundit te miratuar.

Cedimet e kryera te treteve pa respektuar kriteret e treguara me siper ne keto nen ose me nje çmim me te ulet nga ai i kerkuar nga ceduesi ORTAKEVE, jane te pavlefshme dhe nuk do te sjellin pasoje kundrejt ORTAKEVE dhe SHOQERISE.Perveg sa me siper do te zbatohet e drejta e ORTAKEVE per te blere keto kuota me çmimin e ulet te paguar nga personi i trete.

Neni 12 - OPERACIONET FINANCIARE

SHOQERIA ka te drejten e kerkimit dhe pranimit te burimeve te financimit apo kredive,huave etj.,duke ju drejtuar bankave dhe instituteve financiar qe gezojne te drejten e financimit dhe kreditimit.

Neni 13 - BLERJET E SHOQERISE

SHOQERIA disponon dhe gezon pasurite e saj,ne perputhje me qellimin dhe objektin e themelimit te saj.Ajo ka te drejten e blerjes dhe administrimi te pasurive te çdo lloji e natyre si dhe te jape garanci dhe mjete siguri mbi pasurite e saj per permbushjen e detyrimeve qe merr persiper kundrejt te treteve.

TITULLI 3

Financat e SHOQERISE -Bilanci

Neni 14 - BILANCI DHE FONDET E SHOQERISE

SHOQERIA per ushtrimin e aktivitetit te saj krijon fondet e nevojshme si dhe fondin e rezerves e fonde per zhvillim.Perberja,madhesia e tyre,burimi e krijimit,perdorimi e rregullimi i çdo fondi te vecante ne perputhje me

[Handwritten signature]

DRITAN MELLAI
[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

prethanat, interesat dhe objektin e veprimtarise se SHOQERISE, vendosen nga Asambleja e Ortakeve, Keshilli Administrativ apo Administratori i Vetem i SHOQERISE, duke respektuar dispozitat perkatese ne fuqi.

SHOQERIA disponon mjetet e saj financiare. Te gjitha detyrimet e mundeshme gjate veprimtarise se SHOQERISE do te perballohen nga fondet perkatese ose fondet rezerve, ose si alternative me ane te zmadhimit te kapitalit themel-tar. Te gjitha pasurite e SHOQERISE pasqyrohen ne bilancin e saj me vlefte te shprehur ne monedhe shqiptare.

Bilanci dhe llogarite e SHOQERISE perpilohen nga Keshilli Administrativ ose Administratori i Vetem, sipas modaliteteve mbi bilancin e kontabiliteti e shoqerive tregtare te legjislacionit financiar ne fuqi.

Viti financiar (ushtrimori) fillon me daten 1 Janar dhe mbaron me daten 31 Dhjetor te çdo viti kalendarik. Viti i pare financiar mbyllet me daten 31 Dhjetor 1996.

Bilanci vjetor zyrtar detyrimisht i paraqitet Asamblese se Ortakeve brenda gjashte muajve te mbarimit te çdo viti financiar.

Ne perfundim te çdo viti financiar Keshilli Administrativ ose Administra-tori i Vetem merr masat e duhura per pergatitjen dhe perfundimin e bilancit te SHOQERISE, bazuar ne kritere te zgjedhura ne kujdesin maksimal, duke respektuar dispozitat ligjore mbi bilancin dhe kontabilitetin e shoqerive tregtare te legjislacionit shqiptar. Bilancit te SHOQERISE i bashkengjitet nje relacion permbledhes mbi veprimtarine e SHOQERISE gjate vitit financiar. Bilanci dhe relacioni i veprimtarise se SHOQERISE i paraqiten per miratim Asamblese se Ortakeve.

Neni 15 - SHPERNDARJA E FITIMIT

Fitimi neto, pas zbritjes se shumave te detyrueshme per pagimin e tatimeve taksave dhe detyrimeve te tjera ligjore, te shumave per çeljen e fondeve te rezerves e fonde te tjera te nevojshme, do te shperndahet midis ORTAKEVE ne proporcion me kuotat e zoteruara, perveç marrveshjes se kundert te arritur ne Asamblene e Ortakeve.

Pagesa e dividendeve te fitimit neto si ne paragrafin me siper, do te kryhet brenda nje afati te percaktuar nga mbledhja e Asamblese se Ortakeve ne qendren e SHOQERISE. Ne rast se keto dividende nuk terhiqen brenda pese vjeteve, e drejta per t'i terhequr parashkruhet dhe ato kalojne ne dobi te SHOQERISE.

TITULLI 4

Asambleja e Ortakeve - Administrimi i SHOQERISE

Neni 16 - ASAMBLEJA E ORTAKEVE

[Handwritten signature]

BRITAN BEULLAJ

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

Asambleja e Ortakeve perfaqeson teresine e ORTAKEVE dhe vendimet e saj, te marre ne perputhje me ligjin, me AKTIN THEMELUES dhe me kete STATUT, detyrojne te gjitha ORTAKET edhe ne mungese ose ne mendim te kundert. Per kryerjen e veprimave pergatitore, te konsultimeve me shkrim midis ORTAKEVE, thirjen dhe realizimin e sukseseshem te Mbledhjeve te Asamblese se Ortakeve kujdesi per ecurine e tyre dhe barra bie mbi Keshillin Administrativ ose Administratorin e Vetem.

Neni 17 - KOMPETENCA TE ZAKONESHME DHE TE JASHTEZAKONESHME

Asambleja e Ortakeve vendos ne menyre te veçante :

- 1 - per miratimin e bilancit vjetor dhe te programit te veprimtarise se SHOQERISE per vitin e ardhshem,
- 2 - per emerimin e Keshillit Administrativ ose Administratorit te vetem,
- 3 - per ndarjen e fitimit ndermjet ORTAKEVE,
- 4 - per ndryshimin e dispozitave te STATUTIT dhe te AKTIT THEMELUES,
- 5 - per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te SHOQERISE,
- 6 - per emerimin e likujduesit ose likujduesve dhe percaktimin e te drejtave dhe kompetencave te tyre.

Neni 18 - MBLEDHJA E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e Ortakeve, e cila mund te mbledhet ne qendren e SHOQERISE ose jashte saj, si brenda ashtu dhe jashte teritorit te Republikes se Shqiperise thirret se paku nje here ne vit, por jo me vone se 3 muaj nga perfundimi i vitit financiar, mbas njoftimeve me shkrim te cilat u dergohen çdo ORTAKU 15 dite perpara mbledhjes, me leter rekomande me lajmerim marje, ne adresen e sejcilit ORTAK, te treguar ne librin e ORTAKEVE. Njoftimi me shkrim i tyre, per te qene i vlefshem, detyrimisht duhet te tregojte daten dhe oren e thirjes, vendin e thirjes, rendin e dites me specifikimet perkatese lidhur me çeshtjet qe do te shqyrtohen. Çeshtjet qe nuk tregohen ne rendin e dites nuk mund te shqyrtohen, perveçse me marrveshjen unanime te ORTAKEVE te pranishem ne mbledhje, me kusht qe te perfaqesojne tre te katertat e Kapitalit Themeltar te SHOQERISE.

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve drejtohet nga Kryetari i Keshillit Administrativ ose Administratori i Vetem, ne rast mungese nga nje person i emeruar prej tij ose, ne pamundesi, nga nje person i zgjedhur me votim nga Asambleja e Ortakeve.

Kryetari i Mbledhjes se Asamblese emerohet nga ana e tij nje sekretar qofte edhe jo ortak.

Vendimet e Mbledhjes se Asamblese se Ortakeve vertetohen nga nje proces-verbal i nenshkruar nga Kryetari dhe Sekretari i saj.

L. W. GRASSI
[Signature]

BRITAN BELLAS

[Signature]
1955

[Signature]

Ne rastet e parashikuara nga ligji procesverbalet dhe vendimet do të redaktohen nga nje Noter i zgjedhur nga Kryetari i Mbledhjes se Asamblese se Ortakeve, ose nga ai qe e zevendeson.

Nese nuk arrihet perfundim per here te pare, mbledhja e dyte e Asamblese se Ortakeve behet se paku 24 ore pas perfundimit te mbledhjes se pare.

Neni 19 - VLEFSHMERIA - DISKUTIMI - VOTIMI

Asambleja e Ortakeve eshte e vlefshme ne mbledhjen e pare neqoftese jane te pranishem ORTAKET qe perfaqesojne me shume se dy te tretat e Kapitalit themeltar te SHOQERISE.

Vendimet e Asamblese se Ortakeve merren me votat e ORTAKEVE qe perfaqesojne me shume se dy te tretat e Kapitalit Themeltar te Shoqerise, ndersa per kompetencat e Asamblese se Ortakeve te treguar ne pikat kater, pese, gjashte dhe shtate te nenit 17 te ketij Statuti, ato miratohen nga Asambleja e Dashtezakoneshme e Ortakeve, qe kerkon votat e ORTAKEVE qe perfaqesojne me shume se tre te katertat e Kapitalit Themeltar te SHOQERISE.

Te drejten e votes e kane ORTAKET qe jane rregjistruar ne LIBRIN e ORTAKEVE se paku 5 dite perpara mbledhjes se Asamblese se Ortakeve.

Sejcili ORTAK ka te drejten e nje numri votash koresponduese per çdo pjese (kuote) qe ai zoteron ne kapitalin themeltar dhe mund te delegoje me shkri per te marre pjese ne Mbledhjes e Asamblese nje person tjeter qofte jo ort

Neni 20 -

Mbledhja e Asamblese e Ortakeve eshte e vlefshme pa u respektuar formalitetet e thirjes te treguara me siper ne kete STATUT, atehere kur do te jete i perfaqesuar ne ate mbledhje i gjithë kapitali themeltar i SHOQERISE.

Vendimet e Asamblese se Ortakeve jane te detyrueshme si per SHOQERINE ashtu dhe cilindo ORTAK i pranishem ose jo ne ate mbledhje.

Neni 21 - ADMINISTRIMI I SHOQERISE

SHOQERIA administrohet nga nje Keshill Administrativ ose Administratori i Vetem i zgjedhur nga Asambleja ndermjet ORTAKEVE ose jo ORTAKEVE.

Emerimi i antareve te Keshillit Administrativ ose Administratorit te vetem behet nga Asambleja e Ortakeve, perveç emerimit per here te pare qe behet ne AKTIN E THEMELIMIT per nje afat dy vjeçar dhe qe mund te revokohet nga Asambleja e Ortakeve.

Antaret e Keshillit Administrativ ose Administratori i Vetem qendrojne ne kete funksion per nje periudhe qe Asambleja e Ortakeve e percakton ne aktet e emerimit, perveç rasteve te doreheqjes ose te revokimit nga Asambleja.

Luigi G. G. G.
[Signature]

DRITAN BELLAJ
[Signature] *[Signature]*

Neni 22 - KOMPETENCAT E KESHILLIT ADMINISTRATIV OSE TE ADMINISTRATORIT
TE VETEM

Keshilli administrativ zgjedh nga antaret e vet nje kryetar.
Kryetari i Keshillit Administrativ ose administratori i vetem jane te
revokueshem.

Keshilli administrativ emerone nje sekretare, i cili mund te zgjidhet edhe
nga radhet ose jashte radheve te Keshillit.

Neni 23

Keshillit administrativ, ose Administratorit te Vetem i takojne ne menyre
te vecante kompetencat si vijon:

- 1-te vere ne zbatim vendimet e asamblese se ortakeve,
- 2-te organizoje dhe racionalizojne punen per permbushjen e objektit te
shoqerise, duke relatuar ne Asamblene e Ortakeve.
- 3-te administroje pasurine dhe mjetet e SHOQERISE, perfshire mjetet finan-
ciare, ne perputhje me dispozitat e STATUTIT, AKTIT THEMELUES, vendimet
e Asamblese se Ortakeve ose ne aktet ligjore.
- 4-te drejtoje dhe kontrolloje veprimtarine e filialeve, agjensive, perfaqe-
sive, zyrave e te tjera si keto te themeluara nga SHOQERIA.
- 5-te lidhe kontrata te çdo lloji ne emer dhe per llogari te SHOQERISE.
- 6-te beje çdo pagese qe detyrohet SHOQERIA dhe te nenshkruaje kontratat
perkatese per marjet ne pune dhe pushimet nga puna per personalin e
SHOQERISE.

Administratori i Vetem eshte pergjegjes ndaj SHOQERISE per detyrimet qe
jane brenda kompetences se tij ekskluzive.

Neni 24 - PERFAQESIMI DHE FIRMA E SHOQERISE

Te drejten e Firmes dhe te perfaqesimit te SHOQERISE perpara subjekteve
private apo shteterore, vendase apo te huaja, si dhe perpara gjykates e ka
Kryetari i Keshillit Administrativ ose Administratori i Vetem.

Administratori i vetem ka te drejte te delegoje edhe te drejten e firmes,
duke emeruar nje ose disa te prokuruar te posaçem, me perjashtim te se
drejtes per te emeruar te prokuruar te pergjithshem.

Neni 25 - KONTROLLI I AKTIVITETIT EKONOMIKO-FINANCIAR

Per kontrollin e veprimtarise se SHOQERISE, Asambleja e Ortakeve mund te
emeroje nje ose disa eksperte kontrabel te autorizuar. Keta eksperte eme-
rohen çdo vit ushtrimor, jane te riemerueshem dhe nuk duhet te jene puno-
njes te SHOQERISE ose filialeve, agjensive, perfaqesive te saj.

[Handwritten signature]

BRITAN BELLAJ
[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

Neni 26 - MARDHENIET E PUNES

Mardheniet e punes ndermjet SHOQERISE, filialeve e agjensive te saj dhe punonjesve te tyre rregullohen me kontraten e punes. Per çeshtjet e paparashikuara ne kontraten e punes zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi, apo te vendit ku ndodhet filiali etj.

TITULLI 5

Mbarimi - Prishja - Likujdimi

Neni 27 - PRISHJA E SHOQERISE

SHOQERIA priset ne rastet kur

- 1 - mbaron afati i parashikuar ne AKTIN THEMELUES,
- 2 - nuk mund te realizohet objekti i SHOQERISE sipas AKTIT THEMELUES dhe STATUTIT,
- 3 - nje veddim te tille e merr Asambleja e Ortakeve,
- 4 - ne rastet e tjera te parashikuara me ligj.

Neni 28 - LIKUJDIMI I SHOQERISE

Ne rast te prishjes se SHOQERISE ne çfaredo kohe dhe per çfaredo arsye, Asambleja e Ortakeve emerone nje ose disa likujdatore.

Likujdimi i SHOQERISE do te behet sipas dispozitave te legjislacionit falimentar shqiptar ne fuqi ne çastin e likujdimit.

Asambleja e Ortakeve vendos rregullat per procedurat e likujdimit, per personat qe do t'i aplikojne ato dhe per shperblimin e kompetencat e tjera te tyre.

Ne perfundim te procedurave te likujdimit, pasuria neto e SHOQERISE do te shperndahet ndermjet ORTAKEVE ne perpjestim me kuoten respektive te pjesmarjes ne kapitalin themeltar.

Neni 29 - MBYLLJA E FILIALEVE

Asambleja e Ortakeve vendos per mbylljen e filialeve, perfaqesive, agjensive etj. Mbyllja e tyre kur jane te vendosura jashte shtetit, rregullohet me legjislacionin e shtetit ku jane vendosur.

TITULLI 6

DISPOZITATE FUNDIT

Neni 30 - MOSMARRVESHJET

Ne rastin kur do te lindin mosmarrveshje ndermjet ortakeve ose ORTAKEVE dhe SHOQERISE, lidhur me interpretimin ose zbatimin e ketij STATUTI, ORTAKET deklarojne se i besojne zgjidhjen e mosmarrveshjes nje kolegji ekspertesh

Handwritten signatures and initials in the bottom left corner.

Handwritten signatures and initials in the bottom right corner, including the name "DRITAN BEUTAJ".

- 11 -
te cilet si arbitra do te vendosin per zgjidhjen e mosmarrveshjes. Sejcila pale emerone nje ekspert, ndersa nje ekspert emerohet nga Gjykata e rrethit ku ka qendren SHOQERIA.

Kolegji i eksperteve duhet te dorezoje vendimin e zgjidhjes se mosmarrveshjes brenda tridhjete diteve nga emerimi i tyre. Vendimi merret me shumice votash dhe pa formalitete te veçanta. Ky vendim eshte i detyrueshem per palet dhe zbatimi i tij, ne rast se eshte e nevojshme, i paraqitet Gjykates se rrethit Vlore.

Kunder vendimit te arbitrave mund te behet ankim ne Gjykatën e rrethit Vlore.

Neni 31 - DISPOZITA TE ZBATUESHME PER SHOQERINE

Mardheniet ne SHOQERI rregullohen nga dispozitat e AKTIT THEMELUES, STATUTIT, vendimet e Asamblese se Ortakeve, te Keshillit Administrativ ose Administratorit te Vetem dhe qe jane ne perputhje me ligjin. Per mardhenie dhe probleme qe nuk jane treguar shprehimisht ne aktet e mesiperme, do te zbatohen dispozitat dhe aktet ligjore dhe nenligjore te fushes tregetare ose ne pergjithesi.

Neni 32 - DISPOZITE E FUNDIT

Ky statut hyn ne fuqi dite ne rregjistrimit te SHOQERISE ne rregjistrin tregetar te Gjykates se rrethit Tirane.

Ky statut u hartua ne gjuhen shqipe ne 5 (pese) origjinale, te cilat do te depozitohen ne organet kompetente dhe ne dokumentet baze te SHOQERISE. Gjithashtu u perkthye ne gjuhen italiane ne tre kopje.

ORTAKET, pasi e lexuan, e kuptuan dhe e pranuan kete STATUT, e nenshkruan ate pa vrejte sot me date ____ .1995 ne prani te Noterit dhe nga ky moment ky eshte i detyrueshem per ORTAKET.

GRASSI LUIGI

O R T A K E T

DRITAN BELLAJ

PATRIOT ISLAMI

Ky statut u perpilua nga Avokat Pelivan Malaj.

AVOKAT
Dott. PELIVAN MALAJ
Rruga "M. Xhaferi"
VLORE - Tel. 2043

Δ

[Handwritten signature]